

Deri të:

Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Juridik

VLERËSIM I KOMISIONIT MBI DISERTACIONIN E DOKTORATURËS

Në bazë të vendimit nr.13-348/2 të datës 26.06.2025 të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik, për formimin e komisionit për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoratës, si dhe në bazë të nenit 62 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrim dhe studim në ciklin e tretë të studimeve – studimet e doktoratës në Universitetin e Tetovës, komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Ali Musliu, kryetar;
2. Prof. dr. Drita M. Fazlia, anëtar;
3. Prof. dr. Bujar Ahmedli, anëtar;
4. Prof. dr. Vlona Pollozhani, anëtar;
5. Prof. dr. Afrim Osmani, mentor

Pas vlerësimit të punimit të disertacionit të doktoratës me titull "Politika e jashtme e SHBA-së dhe roli i saj në zgjidhjen e kontestit të emrit në mes Maqedonisë dhe Greqisë", të kandidates mr.sc. Ardiana Qamili, komisioni paraqet këtë:

R A P O R T

për vlerësimin e punimit të doktoratës

1. Lënda e hulumtimit

Politika e jashtme e SHBA-së në Ballkan, e orientuar drejt stabilitetit rajonal dhe integritetit euro-atlantik të vendeve të rajonit, ka ushtruar ndikim indirekt në arritjen e kompromisit midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë për çështjen e emrit, që është edhe lëndë studimit të kësaj doktorate. Ky ndikim ka ardhur jo përmes imponimit të drejtpërdrejtë, por përmes krijimit të

iniciativave strategjike – kryesisht perspektivës së integrimit në NATO dhe UE të cilat kanë rritur motivimin e të dy palëve për të arritur marrëveshje.

Analiza e lëndës së kësaj doktrate fillon me hipotezat themelore duke parashtruar pyetjet kërkimore të studimit.

Hipoteza e parë e punimit: Politika e jashtme e SHBA-së e orientuar drejt zgjerimit të stabilitetit dhe sigurisë në Ballkan, ka ushtruar ndikim indirekt duke forcuar motivimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë për kompromis rreth çështjes së emrit, përmes perspektivës së integrimit në NATO dhe në Unionin Evropian.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës që nga mbarimi i Luftës së Ftohtë deri më sot mbetet të jetë fuqi themelore me dhe ndikim të rëndësishëm në ngjarjet ndërkombëtare dhe ato rajonale të Ballkanit Perëndimor.

Hipoteza e dytë e punimit: Angazhimi diplomatik dhe strategjik i SHBA-së në Ballkan ndikoi drejtpërdrejt në krijimin e kushteve të favorshme për nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë. Kjo hipotezë sugjeron se veprimet diplomatike amerikane – përfshirë presionin politik, ndërmjetësimin dhe mbështetjen për integrimin euro-atlantik – ishin faktorë vendimtarë që e shtynë procesin drejt marrëveshjes përfundimtare, faktori amerikan ishte determinant në arritjen e Marrëveshjes së Prespës (2018), e cila zgjidhi kontestin 27-vjeçar për emrin mes Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë. Ajo synon të testojë nëse diplomacia amerikane, ndërhyrjet strategjike dhe interesat gjeopolitike të SHBA-së ishin vendimtare për finalizimin e marrëveshjes.

Në theks të veçantë elaborohet roli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në zgjidhjen e kamotshme të mosmarrëveshjeve ndërmjet Greqisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, lidhur me çështjen e emrit të vendit tonë. Megjithatë, kjo betejë u zhvillua me vite të tëra, që më në fund me ndihmën e aktorëve politikë ndërkombëtar, posaçërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me datë 17 qershor 2018 të arrihet nënshkrimi i Marrëveshjes së Prespës, një marrëveshje historike e nënshkruar nën kornizën e Kombeve të Bashkuara, marrëveshje që zgjidhi një mosmarrëveshje të gjatë mbi përdorimin e emrit “Maqedoni”, një kontest i rrënjosur në çështje historike, kulturore dhe identitare kombëtare të shtetit tonë. Me këtë, me ndërmjetësim të ndërkombëtarëve e posaçërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendit tonë ju hap rruga drejt NATO-s si dhe aderimit në strukturat euroatlantike.

2. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi parësor i këtij hulumtimi është që të nxjerrë në sipërfaqe ndikimin që ka politika e jashtme e SHBA-së në zgjidhjen dhe parandalimin e konflikteve ndërkombëtare si dhe promovimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore në rajon. Thëks të veçantë i vihet edhe ndikimit të politikës së jashtme të SHBA-së në zgjidhjen e çështjes së emrit në mes Maqedonisë dhe Greqisë.

Në vetvete politika e jashtme amerikane është një program veprimi, një projekt që hartohet nga një shtet me përvojë demokratike në planin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Realizimi i saj i përket diplomacisë që është dhe mekanizmi veprues i politikës së jashtme. Pavarësisht frymës së hartimit së një politike të jashtme mënyra se si perceptohet ajo përbën një çështje shumë të rëndësishme.

Shtetet e Bashkuara dhe Maqedonia gëzojnë marrëdhënie të mira dypalëshe, që nga momenti kur që Maqedonia fitoi pavarësinë e saj në vitin 1991. SHBA zyrtarisht njohën Maqedoninë më 8 shkurt, 1994, dhe të dyja vendet vendosën marrëdhënie të plota diplomatike më 13 shtator të vitit 1995, ndërsa në korrik të vitit 1996 dërguan ambasadorin e parë amerikan në Shkup.

Qëllimi për arritjen e stabilitetit ishin në qendër të politikës së jashtme amerikane nga dita e parë e krizës Jugosllave e deri te lufta në Kosovë dhe Maqedoni. Në fazën fillestare të konfliktit, Shtetet e Bashkuara ndërmorën hapin e parë të për të arritur stabilitetin duke mbështetur modelin e shtetit federal. Megjithatë, kur Jugosllavia u shpërbë në vjeshtë të vitit 1991, Shtetet e Bashkuara u lëvizën në hapin e dytë të argumentit të stabilitetit duke u fokusuar vëmendjen në stabilitetin e brendshëm dhe të jashtëm të vendeve të pavarura. Llogaritjet për stabilitet ishin aktuale në pothuajse çdo vendim që Shtetet e Bashkuara e bënë në vazhdimësi.

3. Aplikimi i metodave shkencore

Shikuar aspektin metodologjik, materialet të cilat janë shfrytëzuar në këtë punim janë marrë nga burime të ndryshme shkencore, duke i përdorur metodat: e analizës së përmbajtjes, metodike, diskriptive dhe dogmatiko normative, krahasuese metoda empirike dhe e studimit të rasteve. Metoda hulumtuese përfshin pjesën dhe procesin e identifikimit të burimeve, seleksionim, përpunim dhe përcaktim të vlerësimit të peshës së informatës dhe burimit të informatës, mbledhjes së materialeve qofshin ato të shkruara apo të formës elektronike, tituj shkencorë nga autorë të

vendit dhe të huaj, traktate ndërkombëtare, raporte vjetore të disa organizatave joqeveritare, vendore.

Në kuadër të këtij punimi janë përfshirë dizajni i hulumtimit, qëllimi i studimit dhe objektivat që arrihen, hipotezat dhe pyetje kërkimore, metodologjia dhe procedura e kërkimit, popullata dhe mostra e studimit kuantitativ.

Duke pasur parasysh që informatat për tema të ndryshme jo gjithmonë janë të disponueshme përmes burimeve dytësore, ato u mbledhën nga individë të ndryshëm përmes anketave apo intervistave me persona që kanë qenë të kyçur drejtpërdrejt apo kanë qenë në rrjedha lidhur me këtë temë, prandaj në këtë studim është përdorur metoda e kombinuar, pra kuantitative dhe kualitative. Gjithashtu, kandidatja ka bërë elaborimin e literaturës së ndryshme, ngjarje botërore, deklarata të ndryshme si dhe burime nga interneti për ta shtjelluar më detajisht këtë hulumtim. Është më se e rëndësishme që kandidatja ndalet vetëm tek përvojat e shteteve të ndryshme ku Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë pasur ndikimin e tyre të drejtpërdrejtë, por edhe duke arrit të analizojë lëvizjet e tyre me ndikim të thellë në Ballkanin Perëndimor.

4. Kontributi shkencor i hulumtimit

Ky punim doktrate ka një ndikim pozitiv në hulumtimet e studimeve ndërkombëtare dhe të diplomacisë në përgjithësi. Përdorimi i metodave hulumtuese është hartuar në atë qëllim të që të merren më shumë të dhëna për ta zgjeruar më shumë hulumtimin dhe të jepet një pasqyrë e qartë për rrjedhojën apo arsyet që kanë ndikuar deri në arritjen e vendimit të ndryshimit të emrit të vendit tonë. Gjithashtu, përdorimi i këtyre metodave ndihmon në sfondin shkencor përcakton qasje të ndryshme se çfarë të mirash do t'i sillte vendit tonë ndryshimi i emrit dhe cilat do të ishin perspektivat e vendit tonë në të ardhmen dhe se cilat janë pritshmëritë e qytetarëve nga ky proces i pas ndërrimit të emrit të vendit tonë, sa janë ata optimist apo pesimist për një të ardhme më të mirë për ata dhe gjeneratat e ardhshme në vendin tonë me qëllim të mos emigrojnë më në vendet e jashtme, por ti pret një ardhmëri e begatë dhe e sigurt në vendin e tyre, duke ju siguruar kushte, standarde të larta jetësore në Republikës e Maqedonisë së Veriut.

5. Fusha shkencore e hulumtimit

Pikësynimi i politikës së jashtme amerikane është fokusimi në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë globale, përmes metodave të parandalimit apo të ndërprerjes së konflikteve kur ata kanë marrë hov, ajo që e veçon politikën e jashtme amerikane nga të tjerët është pikërisht: prestigji i superfuqisë së vetme në botë dhe dinamizmi i interesave të saj kombëtare. Asnjë popull tjetër në

botë nuk gëzon pushtetin ideologjik, politik, ushtarak, monetar që gëzon SHBA-ja. Buxheti vjetor i Departamentit të Shteteve të Bashkuara është pothuajse njëmbëdhjetë miliardë dollarë, e cila është më shumë se ajo që mund ta arrijnë së bashku Britania e Madhe, Franca dhe Gjermania (tre anëtare më të mëdha të BE-së). Kjo, megjithatë, është vetëm një pjesë e asaj që me të vërtetë kushton për avancimin e qëllimeve ambicioze të politikës së jashtme amerikane dhe për ta ruajtur statusin si superfuqi globale.

Shtetet e Bashkuara dhe Maqedonia gëzojnë marrëdhënie të mira dypalëshe pasi që Maqedonia fitoi pavarësinë e saj në vitin 1991. Ata zyrtarisht njohën Maqedoninë më 8 shkurt, 1994, dhe të dy vendet vendosën marrëdhënie të plota diplomatike më 13 shtator, të vitit 1995, ndërsa në korrik të vitit 1996 dërguan ambasadorin e parë amerikan në Shkup.

Qëllimi për arritjen e stabilitetit ishin në qendër të politikës së jashtme amerikane nga dita e parë e krizës Jugosllave e deri te lufta në Kosovë. Në fazën fillestare të konfliktit, Shtetet e Bashkuara e ndërmorën hapin e parë të për të arritur stabilitetin duke mbështetur modelin e shtetit federal. Megjithatë, kur Jugosllavia u shpërbë në vjeshtë të vitit 1991, Shtetet e Bashkuara u lëvizën në hapin e dytë të argumentit të stabilitetit duke u fokusuar vëmendjen në stabilitetin e brendshëm dhe të jashtëm të vendeve separatiste. Llogaritjet për stabilitet ishin aktuale në pothuajse çdo vendim që Shtetet e Bashkuara e bënë për njohjen. Pengesë për vendimin amerikan për të zgjeruar marrëdhënie të plota në Maqedoni ishte përjashtimi i vetëm ku politika etnike kishte ndikim.

Shtetet e Bashkuara së bashku me aleatët e saj evropianë, rreptësisht dënuan iniciatorët e konfliktit të vitit 2001 në Maqedoni dhe mbështetën qeverinë dhe përpjekjet e partive më të mëdha të suksesshme për të krijuar një zgjidhje paqësore politike të krizës përmes Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Në partneritet me BE-në dhe organizatat tjera ndërkombëtare në Maqedoni, SHBA-të e lehtësuan zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Qeverisë së Maqedonisë të dhe nxitjen afat-gjatë të paqes dhe stabilitetit në vend.

Gjithashtu, SHBA ndihmoi Maqedoninë e Veriut për të ndërtuar një forcë moderne, forcë mbrojtëse pro-perëndimore me lidhje të ngushta me NATO-n, duke e aderuar Republikën e Maqedonisë së Veriut në strukturat e veta. Në përgjithësi, politika e SHBA-së drejt Maqedonisë së Veriut është që të japë mbështetje financiare dhe politike qeverisë që e shikon si një aleat të bashkëpunimit në rajon. Sipas SHBA-ve, Maqedonia ka luajtur një rol konstruktiv përmes akomodimit me Shtetet e Bashkuara dhe duke nxitur marrëdhënie më të mira me fqinjët e saj dhe

me NATO-n. Megjithatë, ashtu siç bëri në Shqipëri, SHBA është injoruar disa nga problemet që ekzistojnë brenda Maqedonisë. Duhet cekur faktin që Shtetet e Bashkuara mbështet fuqishëm aspiratat e Maqedonisë së Veriut për integrim të plotë në institucionet euro-atlantike. Sot, Maqedonia dhe Shtetet e Bashkuara gëzojnë një marrëdhënie bashkëpunuese të një game të gjerë të çështjeve, si ajo politike, ekonomike, kulturore, ushtarake, dhe sociale. Me ndihmën e dhënë teknike për reforma në demokratike, ekonomike, reformat në mbrojtje, dhe projektet për të forcuar sundimin e ligjit dhe për të përmirësuar arsimin, Shtetet e Bashkuara kanë mbështetur përpërimin e Maqedonisë së Veriut në ndërtimin e një shoqërie demokratike, të sigurt, dhe të orientuar nga tregu multietnik.

Në një botë gjithnjë e më e ngarkuar gjeopolitike, ku marrëdhëniet ndërkombëtare janë të influencuara por jo të dominuara nga forca e globalizimit, fuqia politike do të jetë më e shpërndarë dhe hierarkia më e dobët. Asnjë shtet i vetëm, rajon apo qoftë edhe mbretëri do të prishin që të jenë dominuese, kështu që politika e jashtme unilaterale e SHBA-së, i bazuar në hegjemonizmin amerikan global dhe ekonomik, thënë realisht ka mangësi.

Kështu mund të vijmë në përfundim që nëse SHBA-t vazhdojnë të dobësohen dhe të udhëheqin politikën e jashtme shkurt pamë se përjetojnë një rënie të madhe në skenën botërore. Kandidatja potencon që shekulli XXI do të jetë "Shekull Global" e jo ajo "Amerikan". Në punim konstatohet që Shtetet e Bashkuara do të duhet të sfidon vendet tjera apo të aplikojnë me forcën e vet në çështjet ndërkombëtare, përmes urtësisë, qëndrueshmëri në të vendosurit, si dhe të përgjegjshëm në ushtrimin e pushtetit.

6. Rezultatet e hulumtimit

Shtetet e Bashkuara të Amerikës luajnë një rol të veçantë dhe të rëndësishëm në çështjet ndërkombëtare. Një shembull i qartë i këtij ndikimi është politika e jashtme amerikane ndaj Republikës së Maqedonisë së Veriut, veçanërisht në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes për emrin me Greqinë atëherë e njohur si Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë (IRJM). Kjo tezë fokusohet në mënyrën se si pritej të ndikonte dhe se si realisht ndikoi zgjidhja e kësaj mosmarrëveshjeje në drejtimin politik dhe diskursin publik të vendit, në perspektivën politike dhe ekonomike si dhe në pritshmëritë e qytetarëve para, gjatë dhe pas procesit të negociatave të emrit.

Instrumentet e këtij studimi janë intervistat që janë bërë me persona eminent të politikës dhe diplomacisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes pyetjeve të parashtruara si dhe përgjigjeve të mara kemi marrë përgjigje nga më të ndryshmet që kanë qenë esenciale për

vlefshmërinë e këtij punimi si dhe për të arritur deri tek e vërteta dhe për të ndjek zhvillimet e proceseve që kanë çuar deri tek ndryshimi i emrit të vendit tonë, proces i cili na jep shpresë për një të ardhme më të mirë të vendit tonë dhe standardit më të lartë jetësor të qytetarëve tanë.

Siç përmendëm edhe më lartë, intervistat enkas për studim dhe hulumtim janë bërë me persona që kanë qenë të kyçur në procese vendimmarrëse të vendit tonë, gjegjësisht, intervistë me Prof. Dr. Nano Ruzhin, i cili në të kaluarën është përzgjedh dy herë të jetë anëtarë i Parlamentit në Republikës e Maqedonisë së Veriut prej vitit 1994 e deri më vitin 2001. Në vitin 2001, Prof. Dr. Nano Ruzhin nga ana e ish kryetarit të shtetit Boris Trajkovski, u nominua si Ambasador në NATO i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Bruksel, i cili veproi deri në vitin 2008.

Intervista e radhës është bërë me z. Muhamed Halilin, i cili ndër vite ka qenë pjesë e zhvillimeve dhe proceseve që kanë ndodhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut që nga konstituimi i saj si shtet i pavarur. Ai prej vitit 1994 e deri në vitin 1996 ka qenë Ministër pa resor në republikën e Maqedonisë së Veriut, prej vitit 1996 e deri në vitin 2000 ka qenë ambasador fuqplotë i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Danimarkë, prej vitit 2000 deri në vitin 2002 ka qenë Zëvendës Ministër i Punëve të Jashtme në Republikës e Maqedonisë së Veriut, prej vitit 2005 deri vitin 2008 zëvendës ambasador në Londër dhe prej vitit 2009 e deri në vitin 2020 ka qenë Ambasador fuqplotë i shtetit tonë në Luksemburg.

Për nevojat hulumtimit shkencor intervista është zbatuar me z. Bujar Osmanin, politikan shqiptar në Republikës e Maqedonisë së Veriut. I njëjti ndau me ne përvojat shumëvjeçare të proceseve politike të shtetit tonë, pasi që ka qenë drejtpërdrejt i kyçur në vendimmarrjet e ndryshme shtetërore. Ai prej vitit 2008 e deri në vitin 2011 ishte Ministër i Shëndetësisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në qershor të vitit 2017 u emërua Zëvendës Kryeministër për Çështje Evropiane në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe prej vitit 2020 e deri në vitin 2024 u emërua Ministër i Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pikërisht duke qenë si Ministër i Punëve të Jashtme, z. Bujar Osmani ndau me ne përvoja dhe mendime të ndryshme lidhur me ecuritë e deritanishme si dhe duke shprehur mendimin dhe përvojën e vetë se si do të mund të rrjedhin proceset euro integruese të vendit tonë.

7. Kontributet kryesore shkencore të kandidatit

Gjatë periudhës së studimeve kandidati ka marr pjesë në disa konferenca tematike për problematikën e në fjalë dhe në mënyrë aktive punon në hulumtime tjera lidhur me këtë problematikë. Angazhimi i kandidatit përfshinë pjesëmarrje dhe prezantim të punimeve shkencore

në disa konferenca shkencore, publikim të punimeve në revista shkencore me karakter ndërkombëtar.

8. Fusha shkencore në të cilën do të aplikohen rezultatet

Ky studim vë në pah ndërveprimin kompleks midis diplomacisë ndërkombëtare, qeverisjes së brendshme dhe perceptimit publik në kontekstin e rrugëtimit të Maqedonisë së Veriut drejt integritetit euroatlantik. Ndërsa zgjidhja e mosmarrëveshjes për emrin me Greqinë përfaqëson një arritje të rëndësishme diplomatike e ndikuar ndjeshëm nga politika e jashtme e SHBA-së dhe ndërmjetësimi ndërkombëtar përparimi i pritur politik dhe ekonomik nuk është realizuar në masën që pritej nga aktorët ndërkombëtarë dhe popullsia vendase. Ndjenja mbizotëruese, si te ekspertët ashtu edhe te qytetarët, reflekton një ndjenjë të thellë zhgënjimi, kryesisht për shkak të korrupsionit të vazhdueshëm të elitës politike vendase dhe dështimit të aktorëve ndërkombëtarë për të përmbushur zotimet e tyre, veçanërisht në lidhje me anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Këto gjetje theksojnë rëndësinë e zgjidhjes jo vetëm të mosmarrëveshjeve formale, por edhe të ndjekjes së angazhimeve në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, në mënyrë që të sigurohet stabilitet politik afatgjatë dhe besimi i qytetarëve.

9. Hulumtime të mundshme në të ardhmen

Duke e marr parasysh atë se kjo temë nuk ka qenë mjaftueshëm e trajtuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, konsiderojmë se ekziston mjaftë hapësirë për t'u studiuar më gjerësisht, me qëllim për t'u analizuar nga bota akademike dhe studiues të ndryshëm.

I gjithë roli i SHBA-së në kontestin ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë ishte që të parandalojë një konflikt të ardhshëm dhe aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në strukturat euroatlantike. Ky proces sot e kësaj dite ende nuk ka marrë përfundim, pasi që shteti jonë pret që të jetë pjesë e Unionit Evropian, prandaj ka edhe shumë punë për tu bërë si dhe identifikimin e pengesave dhe tejkalimin e tyre për tu aderuar në Unionin Evropian.

10. Përfundim me propozim

Komisioni konstaton se punimi me temë "Politika e jashtme e SHBA-së dhe roli i saj në zgjidhjen e kontestit të emrit në mes Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë", e kandidatës mr.sc Ardiana Qamili i plotëson kushtet që të punohet si punim i pavarur shkencor dhe sipas metodologjisë së propozuar, është adekuat për vlerësuar afësisht e kandidatit si hulumtues i pavarur shkencor.

Komisioni vlerëson se punimi i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren për kushtet, kriteret dhe rregullat e regjistrimit dhe studimit në ciklin e tretë të studimeve të doktoratës në Universitetin e Tetovës për fillimin e punimit shkencor të temës së doktoratës.

Komisioni i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik që të sjell vendim për miratim të këtij raporti dhe të vazhdohet me procedurat e mbrojtjes së tezës së doktoratës "Politika e jashtme e SHBA-së dhe roli i saj në zgjidhjen e konfliktit të emrit në mes Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë", të kandidates Ardiana Qamili.

Tetovë, 12.12.2025

K o m i s i o n i :

1. Prof. dr. Ali Musliu, kryetar

2. Prof. dr. Drita M. Fazlia, anëtar

3. Prof. dr. Bujar Ahmedi, anëtar

4. Prof. dr. Vlona Pollozhani, anëtar

5. Prof. dr. Afrim Osmani, mentor

